

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Si e raportoi MEDIA SERBE vendimin për Thaçin, Veselin, Krasniqin dhe Selimin Gazeta Shqip
ADRESA	https://gazeta-shqip.com/me-rendesi/si-e-raportoi-media-serbe-vendimin-per-thacin-veselin-krasniqin-dhe-selimin/
BURIMI	gazeta-shqip.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 00:58:35 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 13:30:25 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	2f840e6e74f90535410a8ce8abc35533a95c4646a325afe78e1437634da06a6e
TEKSTI	6d0a3096a754df0f4560ce399daa84cd5222aa73bfcc6179d7893f579424fa35
PAMJA	3bbe1b100c3f5eb9cbbab078f39302b2e9c099b0e9f6073b521477fbb31fe468

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	f4d7aad58dc02317c0ae81802ceb597c7fec9eb54caf460c61476155d9b56100
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	f3a7f3b1840b8c1fdf37cf45c7cf9cf417896e420137132777a1bf295bf8fe5f
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/f4d7aad58dc02317c0ae81802ceb597c7fec9eb54caf460c61476155d9b56100>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

ME RËNDËSI

Si e raportoi MEDIA SERBE vendimin për Thaçin, Veselin, Krasniqin dhe Selimin



12:30 | 16 SHTATOR 2026

SHPERNDA ▾

Vendimi i Dhomave të Specializuara ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit ka marrë hapësirë të konsiderueshme edhe në mediat serbe. Gazeta Kurir ka ndjekur në mënyrë të detajuar shpalljen e aktgjykimit në Hagë, duke raportuar si për dënimet, ashtu edhe për reagimet që pasuan në Kosovë dhe në Holandë.

Në artikullin kushtuar procesit, Kurir përdor termin “OVK” për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës dhe një gjuhë të fortë në përshkrimin e saj. Katër ish-drejtnesit përshkruhen nga media serbe si “ish-komandantë të OVK-së”.

Në qendër të raportimit janë masat e dënimit të shpallura nga trupi gjyqës.

Kurir shkruan se Hashim Thaçi dhe Jakup Krasniqi janë dënuar me nga 25 vite burgim, Kadri Veseli me 18 vite dhe Rexhep Selimi me 13 vite. Të mbledhura së bashku, dënimet arrijnë në 81 vite burg.

Media serbe ndalet edhe te arsyetimi i dhënë gjatë leximit të aktgjykimit, duke veçuar dallimin që trupi gjyqës bëri mes akuzave për krime lufte dhe atyre për krime kundër njerëzimit.

Sipas pasqyrit të Kurir, gjykata konstatoi se veprimet e pretenduara pas 20 qershorit 1999 nuk mund të trajtoheshin si krime lufte në kuadër të këtij procesi, për shkak të përfundimit të konfliktit të armatosur. Në artikull evidentohet gjithashtu se për disa prej akuzave për krime kundër njerëzimit nuk u konsideruan të provuara përtej dyshimit të arsyeshëm elementet juridike të nevojshme.

Por vëmendja e medias serbe nuk është kufizuar vetëm te ajo që ndodhi brenda sallës së gjyqit.

Kurir ka raportuar edhe atmosferën në Prishtinë, ku qytetarë të shumtë u mbloodhën për të ndjekur në një ekran të madh transmetimin e drejtpërdrejtë nga Haga. Media shkruan se gjatë tubimit u dëgjuan thirrje në mbështetje të UÇK-së dhe se në kryeqytetin e Kosovës ishte shtuar prania e forcave të policisë.

Në raportim përfshihen gjithashtu zhvillimet jashtë selisë së Dhomave të Specializuara në Hagë. Sipas Kurir, mbështetës të ish-drejtuesve të UÇK-së ishin grumbulluar pranë gjykatës përpara aktgjykimit.

Media serbe raporton se policia holandeze u kërkoi më pas të pranishmëve të largoheshin nga zona, kërkesë pas së cilës grumbullimi pranë ambienteve të gjykatës u shpërnda.

Në këtë mënyrë, Kurir e ka trajtuar gjerësisht aktgjykimin e Hagës, duke ndërthurur dënimet e dhëna ndaj katër ish-drejtuesve të UÇK-së me pjesë të arsyetimit të gjykatës dhe reagimet që vendimi shkaktoi në Prishtinë dhe Hagë.



GAZETA SHQIP

Rreth nesh
Marketing
Newsletter
Mundësi Punësimi
Kontakt

TOP ALBANIA RADIO

News
Shows
Video
Podcasts

MORE

Top Channel
TimeOutTirana
Top Music Awards

SOCIAL



Newsletter

Regjistrohu

[Privacy Policy & Terms of Use](#) | [Cookie Policy](#)

gazeta shqip

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.